



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Legjislatura e III-të
Nr. 06/08
Prishtinë, më 3.04.2008, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit për Buxhet dhe Financa

Anëtarët e pranishëm të Komisionit: Gani Koci, Haki Shatri, Kosara Nikolić, Safete Hadërgjonaj, Hajdin Abazi, Armend Zemaj, Myrvete Pantina, Xhevdet Neziraj, Besa Gaxherri, Müfera Şinik, Shkumbin Demaliaj.

Anëtarët jo të pranishëm: Behxhet Pacolli.

I ftuar: Hasan Preteni, drejtor i Agjencionit Kosovar Kundër Korrupsionit.

Nga shërbimi i sekretarisë: Natasha Tisma-Prica, Arta Hajra, Vilson Ukaj, Dashurie Canolli.

Gjithashtu të pranishëm ishin: monituroes nga OSCE, KDI, NDI, ZPK.

Kryesues: Gani Koci, kryetar i komisionit

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**

3. Shqyrtimi i Raportit Vjetor të Agjensionit Kundër Korrupsionit për vitin 2007, me Përfundimin e Kryesisë së Kuvendit lidhur me kërkesën e Agjensionit Kundër Korrupsionit për emërimin e tre anëtarëve të Këshillit të këtij Agjensionit;
4. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi në Projektligjin për parandalimin e pastrimit të parave;
5. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. L-017/1 të Inspektoratit të Punës, me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, me amendamente;
6. Shqyrtimi i propozimit të Planit të Punës së Komisionit për vitin 2008;
7. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Haki Shatri për shkak të vonesës së arsyeshme të kryetarit, zëvendës kryetari i parë i Komisionit i autorizuar nga kryetari hapi mbledhjen dhe prezantoi rendin e ditës.

Rendi i ditës u miratua si i tillë i propozuar.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Procesverbali nga mbledhja e kaluar dt. 20.03.2008, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit Vjetor të Agjensionit Kundër Korrupsionit për vitin 2007, me Përfundimin e Kryesisë së Kuvendit lidhur me kërkesën e Agjensionit Kundër Korrupsionit për emërimin e tre anëtarëve të Këshillit të këtij agjensionit

Kryetari kërkoi nga anëtarët që me rastin e komentimit të raportit të keni parasysh Ligjin Kundër Korrupsionit sepse ai ligj ka disa restriksione gjë që ka ndikuar që ky raport të jetë më i kursyer, këtë e tha nga përvoja e tij në hartimin e këtij Ligji dhe si anëtar i Këshillit të Agjensionit. Më pas ia dha fjalën drejtorit të AKK, z. Hasan Preteni.

Hasan Preteni filloi paraqitjen e raportit me prezantimin e Agjensionit si një organ të pavarur për luftimin dhe parandalimin e korrupsionit dhe koordinimin e politikave antikorrupsion. Fondet e Agjensionit sigurohen nga buxheti i Kosovës. Sipas z.Preteni aktivitetet e Agjensionit mbështeten në tri shtylla kryesore:

- Zbatimi i ligjit;
- Parandalimi i korrupsionit dhe
- Edukimi.

Sa i përket zbatimit të ligjit, Agjensioni siguron informata që kanë të bëjnë me veprimet korruptive dhe të njëjtat i janë përcjellur Prokurorisë Publike. Agjensioni ka për obligim të mbikëqyrë pasurinë e zyrtarëve të lartë publik, të ndërhyj aty kur vëren se ka konflikt interesi dhe të mbikëqyrë pranimin e dhuratave që pranojnë këta zyrtar.

Aktiviteti tjetër i rëndësishëm i Agjensionit është edukimi i administratës publike në bazë të kornizën ligjore dhe mekanizmave aktual antikorrupsion, si dhe ngritja e vetëdijes qytetare për bashkëpunim në luftën kundër korrupsionit. Në këtë drejtim theksoi se kanë instaluar një linjë telefonike pa pagesë për qytetarët, të cilët mund të i përcjellin informatat në Agjension. Po ashtu është krijuar edhe Web faqja ku të gjithë të interesuarit mund të njihen me punën e Agjensionit. Bazuar në Ligjin përkatës të gjitha informatat si për nga burimi, emri i personit dhe përmbajtja e

këtyre informatave lidhur me personat që pretendohet se kanë kryer veprime korruptive janë konfidenciale.

Më tutje z. Preteni shpjegoi pjesën tabelore të rasteve të paraqitura. Janë paraqitur 124 rastet cilat janë hetuar në aspektin administrativ, janë grumbulluar materialet, janë materializuar ato dhe më pas janë përcjellur për në Prokurori. Prej këtyre rasteve 61 janë mbyllur në mungesë të materialit dëshmues, 47 raste tjera janë dërguar në Prokurori, ndërsa 16 janë duke u hetuar. Më së shumti raste janë dërguar në Prokurorinë Publike të Prishtinës, duke pasur parasysh faktin se shumica prej tyre kanë të bëjnë me Institucionet Qendrore. Në vazhdim paraqiti problemet që po përballet Agjensioni:

- Bashkëpunimi jo i mirë me Prokuroritë Publike, mbyllja e “shpejtë” e rasteve dhe kthimi i përgjegjëve brenda një afati dhjetë ditor, nga të gjitha rastet e dërguara atje vetëm gjashtë prej tyre jemi informuar dhe të gjitha janë hedhur poshtë. Karakteristikë e tyre është se pesë prej tyre i përkasin gjykatave;
- Vështëritë në menaxhimin e buxhetit, për shak të mungesës së zyrtarëve për zotim, prokurim, çertifikim;
- Pagat e ulëta, që ka ndikuar në demotivimin e punonjësve dhe ikjen e ekspertëve;
- Problem tjetër është mosrregullimi i statusit të Këshillit që mbikëqyr Agjensionin;
- Objekti jo i siguruar sa duhet, paraqet rrezik për punën e zyrtarëve të Agjensionit.

Agjensioni për të gjitha informatat që kanë të bëjnë me rastet hetuese të veprimeve korruptive përcakton edhe vlerën e tyre, se sa këto veprime mund të dëmtojnë buxhetin e Kosovës. Nga përlllogaritë që kemi bërë, nga 47 rastet e dërguar në Prokurori kanë peshën e 30 milion Eurove. Agjensioni nuk përzier në çështjet që tashmë ka filluar proceduara nga ndonjë organ tjetër. Zyrtarët tonë kanë marrë pjesë në hartimin e dy ligjeve: Ligjin për deklarimin dhe kontrollin e pasurisë dhe Ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit. Sa i përket deklarimit të pasurisë në raport janë pasqyruar 732 raste që kanë qenë të obliguar ta deklarojnë pasurinë e tyre dhe prej tyre 713 e kanë deklaruar. Nga statistikat që kemi pasqyruar në raport 14 zyrtar që nuk e kanë deklaruar pasurinë, tetë prej tyre janë nga Kuvendi ndërsa gjashtë të tjerë nga Gjyqësori. Vlerësoi bashkëpunimin e mirë që ka me Njësinë e Intelgjencës Financiare, SHPK-në dhe Policinë e UNMIK-ut, ku informatat tyre kanë qenë joshëse për ata.

Sa i përket dhuratave, vitin 2007 kemi bërë përgatitjet, kemi përgatit katalogët dhe në këtë vit kemi dorëzuar për plotësim zyrtarëve përkatës.

Një e arritur e madhe e Agjensionit në luftimin korrupsionit ka qenë edhe fushata mediale që e ka bërë bashkërisht me OSCE-në dhe UNDP-në. Pastaj vizitat e bëra nëpër komuna. Vizita studimore në vendet Evropiane për të shkëmbyer përvojat, shumica prej tyre janë mundësuar me financimin e donatorëve ndërkombëtar.

Në fund të prezantimit z.Preteni paraqiti perspektivat e Agjensionit:

- Fuqizimi i punës së Agjensionit;
- Kompletimi i stafit, ashtu siç është paraparë me ligj prej 35 zyrtarëve;
- Trajnimi dhe avancimi i stafit ekzistues dhe atyre që do të pranohen;
- Hartimi i një strategjie të qartë të Agjensionit në luftë kundër korrupsionit, e cila kalon nëpër Qeveri e prej aty në Kuvend për aprovim.

Besa Gaxherri vlerësoi relativisht të mirë raportin e paraqitur nga AKK, duke marrë për bazë problemet që ka ky Agjension, si mungesa e kuadrit profesional, mungesa e mjaftueshme e buxhetit. Znj.Gaxherri kërkoi që Agjensioni të veprojë i pavarur dhe i mbështetur nga Institucionet shtetërore edhe pse shprehu dyshimin se këto institucione po ndërhyjnë në aktivitetet e tij pasi edhe heton pikërisht punën e tyre. Shprehu shqetësimin për dyshimi e pranisë së korrupsionit në Kuvendi dhe Organet Gjygjësore, si dy institucione shembull i zbatimit të ligjit. Kërkoi nga përfaqësuesi i Agjensionit që të marrin guximin dhe të mbajnë kontakte të vazhdueshme me

komisionin të siguroj informata që kanë të bëjnë me zyrtaret e institucioneve e në veçanti me deputet e Kuvendit. Për një efikasitet të tillë kërkoi që Kuvendi të përmisojë kushtet e veprimit të tij, si pagat e zyrtarëve të jenë në nivel me Agjensionit tjera relevante, si ZRRE dhe ART dhe të sigurohet objekti për punë normale.

Xhevdet Neziraj vlerësoi pozitivisht raportin e paraqitur. Pati vërejtje rreth ikjes së ekspertëve, gjë që i ka ndodhur edhe këtij Agjensionit. Kërkoi nga Institucionet dhe Organizmat tjerë shtetëror që ekspertët e trajnuar me fondet publike të i'u kushtëzohet qëndrimi aty për një kohë të caktuar, natyrisht që me pagë të arsyeshme. Z. Neziraj u shpreh i kënaqur me rezultatin e deklaramit të pasurisë, me një përqindje të kënaqshme. Kërkoi që Agjensionit të jetë dhe të mbetet i pavarur në punën e tij.

Armend Zemaj përgëzoi për punë e bërë nga Agjensionit gjë që është pasqyruar edhe në raport. Në veçanti vlerësoi për punën të suksesshme që është bërë me fushatën mediale. Parashtrroi një pyetje: lidhur me shumën e 30 milion Eurove, lënda e të cilave është dërguar edhe në Departamentin për Krime Ekonomike, kërkoi të dijë se cili është raporti pas dërgesës së informatave, a është bërë vetëm paraqitje e rasteve apo edhe janë marrë informacione se është dëmtuar buxheti në atë masë.

Myrvete Pantina duke pasur parasysh kohën e shkurtër të veprimit, vlerësoi pozitivisht raportin e paraqitur. Me gjithë këto suksese të arritura, ajo shprehu shqetësimin për praninë e korrupsionit në shoqërinë kosovare, gjë që dëshmon edhe statistikat e bëra nga një organizatë botërore ku Kosova figuron në vendin e tretë apo katërt për praninë e korrupsionit në vend. Formularët nuk janë plotësuar si duhet, andaj pyeti si kanë vepruar në ato raste ku mungojnë të dhënat e plota. Për shkak të rrezikshmërisë më të madhe në këtë Agjension kërkoi që zyrtarët të motivohen më shumë në paga. Pyeti: a e ndien stafi vetën të sigurt dhe a keni pasur raste të kërcënimit në punën që e keni bërë. Për deklarimin e dhuratave shprehu dyshimin në efikasitetin e këtij instrumenti, për shkak të mosgatishmërisë së zyrtarëve për deklarimin e tyre.

Shkumbin Demaliaj theksoi se paraqitja e raportit është obligim i Agjensionit si pjesë e përgjegjësisë që e obligon Ligji. Në vendet e zhvilluara ky mekanizëm nuk funksionon sepse i kanë mekanizmat funksional institucional, siç janë Prokuritë, Ministria e Drejtësisë dhe Policia të cilët në mënyrë profesionale me instrumentet e tyre e luftojnë korrupsionin. Ndërkaq Institucionet e Kosovës e kanë krijuar këtë mekanizëm në mënyrë që ta fshehin korrupsionin që zhvillojnë ato, duke ditur mostraparancën e tyre për punën që bëjnë. Pasi Kuvendi ka krijuar këtë Agjension duhet mundësoj veprimin e lirë dhe të pavarur të tij, duhet sigurojë buxhetin e mjaftueshëm, të ofrojë sigurinë e personave dhe objektit, e pastaj të kërkoi llogari dhe raport konform Ligjit që ka themeluar atë.

Safete Hadërgjonaj falënderoi për raportin përmbajtësor dhe gjithëpërfshirës, që e veçon atë nga raportet e Agjensioneve të pavarura. Është fakt se veprimtaria e Agjensionit nuk është shumë i pranueshëm për institucionet, sidomos në ato ku është e pranishme dukuria e korrupsionit. Sa i përket rasteve të paraqitura znj. Hadërgjonaj theksoi se e shqetëson shumë fakti që shumica prej tyre kanë të bëjnë me Gjykatën, duke ditur rolin e saj në luftimin e korrupsionit në një shoqëri. Gjithashtu brengos problemi i kthimit të shpejt të përgjegjësve nga Prokuroritë për rastet dyshuese për gjyqtarë, andaj kërkoi nga deputetet trajtim më serioz për këtë çështje në Kuvend. Më pas parashtrroi një pyetje: duke ditur se keni marrë pjesë në hartimin e legjislacionit, a keni ndonjë propozim se në cilin Ligj mund të ndërhyhet për të plotësuar dhe ndryshuar e që do të mund të ndihmonte për punën më efikase në luftimin e korrupsionit.

Hajdin Abazi u pajtua me mendimet parafolësve rreth vlerësimit pozitiv të Agjensionit dhe raportit të tij. Konsideroi shqetësuese mbylljen e 61 rasteve, mundësin e dëmtimi për 30 milion Eurove të buxhetit të Kosovës. Po ashtu theksoi se e brengos fakti i zgjidhjes së shpejtë të rasteve. Parashtrroi një pyetje: shtypi ka shkruar për parregullsitë në Institucionet shtetërore duke u bazuar në raportet e Auditorit Gjeneral, a i'u kanë shërbyer rezultatet e këtyre raporteve si burim për të hapur procedurën ndaj atyre që dyshohet se kanë kryer veprime korruptive. Garantoi mbështetjen e plotë të punës së tyre.

Kryetari duke ditur rolin dhe rëndësinë e këtij Agjensionit kërkoi që Kuvendi të mbështete atë në aspektin financiar, kadrovik dhe teknik. U pajtua që komunikimi elektronik të jetë i ndarë nga rrjeti qeveritar për shkak të pavarësisë së informacioneve që ka. Shqetësues fakti i pranisë së rasteve në Gjykata dhe shpejtësia e kthimit të përgjegjëve nga Prokuroritë, prandaj kërkoi që Kuvendi të marrë masa urgjente nëpërmes Ministrisë së Drejtësisë që të ndërhyj në sistemin e drejtësisë dhe të spastroj elementet e korrupsionit që mund të egzistojnë aty.

Hasan Preteni u përgjegj pyetjeve të anëtarëve të komisionit. Lidhur me pyetjen e znj. Pantina tha se nuk ka pasur kërcnim direkt në punën e tij. Po ashtu u pajtua me z. Neziraj se duhet ruajtur ekspertët dhe kjo duhet rregullohet me kontratë me të cilën do të duhej të kushtëzohet përmbushja e saj. Rreth pyetjes së z. Abazi theksoi se Agjensioni grumbullon informata dhe i dërgon në Prokurori, ndërsa për informatat e publikuara nga institucionet tjera, Agjensioni nuk është kompetent të i shqyrtojë. Në pyetjen e znj. Pantina rreth pozicionimit të Kosovës në vendin e tretë apo katërë për nga prania e korrupsionit, tha se këto shifra nuk janë të sakta, megjithëse pranoi se dukuria e korrupsionit është e evidente. Po ashtu u akordua me mendimin që objekti duhet siguruar, në mënyrë që të garantohet puna në të. Për dhurata theksoi se ky aktivitet ka filluar këtë vit dhe po presin rezultatin. Po ashtu u shpreh i brengosur për bashkëpunimin jo të mirë me Organet Gjyqësore. Në pyetjen e z. Zemaj për shumën 30 mili. Eurove, shpjegoi se ky është një vlerësim që ka bërë Agjensioni për lëndët e dërguara në Prokurori, që në rast të konstatimit të tyre buxheti i Kosovës do të dëmtohej në këtë masë. Lidhur me pyetjen e znj. Hadërgjonaj theksoi se zyrtarë e Agjensionit propozimet dhe rekomandimet e veta i kanë inkorporuar gjatë draftimit të legjislacionit.

Pas vërjetjeve dhe sugjerimeve, Kryetari hodhi në votim raportin e AKK, pas votimit të bërë me shumicë votash Komisioni nxori këtë:

REKOMANDIM

Komisioni për Buxhet dhe Financa përkrah raportin e Agjensionit Kosovar Kundër Korrupsionit (AKK) për vitin 2007 dhe i rekomandohet Kryesisë së Kuvendit që të njëjtin ta rradhit në rend dite për shqyrtim dhe miratim në seancën Plenare të radhës.

Rreth kërkesës së Kryesisë së Kuvendit për propozimin e tre anëtarëve në Këshillin e Agjensionit, Komisioni shqyrtoi të njëjtën dhe bëri dy propozime: të formohet një grup prej katër anëtarëve të komisionit që së bashku me Komisionin për Siguri të bëjnë propozimet dhe propozimi i dytë të kërkohet nga Kryesia që grupet parlamentare të bëjnë propozimet e tyre dhe pastaj të votohen në Kuvend.

Pas këtyre propozimeve dhe vërejtjeve të bëra, komisioni me shumicë votash nxori këtë:

REKOMANDIM

Komisioni për Buxhet dhe Financa i rekomandon kryesisë së Kuvendit që propozimet për emërimin e tre anëtarëve në Këshillin e Agjencionit Kosovar Kundër Korrupsionit të i bëjnë grupet parlamentare dhe mëpastaj të votohen në Kuvend.

4. Shqyrtimi raportit të Komisionit për Legjislacion dhe Gjqësi në Projektligjin për parandalimin e pastrimit të parave

Kryetari lexoi raportin e Komisionit funksional lidhur me shqyrtimin e bazës juridike në P/L për parandalimin dhe pastrimin e parave dhe kërkoi nga anëtarët që ta mbështesin atë.

Pasi nuk kishte vërjetje, Komisioni me shumicë votash nxori këtë:

REKOMANDIM

Komisioni për Buxhet dhe Financa përkrah raportin e Komisionit funksional lidhur me shqyrtimin e bazës juridike të Projektligjit për parandalimin dhe pastrimin e parave dhe i rekomandon Kuvendit që në procedurë të mëtejme ta miratojë atë.

5. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. L-017/1 të Inspektoratit të Punës, me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, me amendamente

Kryetari lexoi raportin e Komisionit funksional- Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, me amendamente, lidhur me P/L për ndryshimin dhe plotësimin e Inspektoratit të Punës nr.L-017/1, theksoi se nuk përmban implikime buxhetore dhe kërkoi nga anëtarët ta mbështesin atë.

Shkumbin Demaliaj u shpreh kundër amendamenteve të propozuara nga Komisioni funksional, të cilat nuk u përgjigjen Projektligjit për ndryshim dhe plotësim të Inspektoratit të Punës. **Z. Demaliaj** theksoi se këto propozime nuk bazohen as në ligjin për Inspektoriatin e Punës që ka nxjerr Kuvendi. Amendamentet e propozuara janë mbështetur në interesat e ish puntorëve që kanë punuar në masa të dhunshme në Komunën e Prishtinës, propozime janë bërë me qëllim që të krijojnë vetes mandat për dualitet në mes Ligjit për përfitime të honorarëve brenda orarit të punës të shërbyesve civil. Bëri vërejtje konkrete amendamentit 8, ku parashihet krijimi i Kryeinspektorit dhe inspektorët e punës, ndërsa nuk definohet qartë kompetenca territoriale për veprimin e tyre. Nuk mundet që inspektori i Prishtinës të veproj në Prizren apo edhe e kundërta. Propozoi që të mbetet projektligji i tillë siç ka ardhur nga qeveria.

Armend Zemaj si anëtarë i komisionit funksional, theksoi se komisioni në fjalë i ka propozuar amendamentet dhe mbështetur në mënyrë unanime. Propozimet e bëra kanë për qëllim që të shmangin interesat personale dhe karrieriste që janë mundësuar me Projektligjin e propozuar nga qeveria.

Pas vërejtjeve të bëra, Komisioni me shumicë votash nxori këtë:

REKOMANDIM

Komisioni për Buxhet dhe Financa përkrah Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. L-017/1 të Inspektoratit të Punës, me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Shëndetësi,

Punë dhe Mirëqenie Sociale, me amendamente me konstatimin se Projektligji dhe amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore dhe i rekomandon Kuvendit që në procedurë të mëtejme ta miratojë atë.

6. Shqyrtimi i propozimit të Planit të Punës së Komisionit për vitin 2008

Pasi nuk kishte propozime me shkrim apo më gojë, Komisioni me shumicë votash nxori këtë:

K O N K L U Z I O N

Miratohet Plani i Punës së Komisionit për vitin 2008 me mundësi të plotësimit dhe ndryshimit të tij gjatë aktivitetit të punës së Komisionit.

7. Të ndryshme

Kryetari njoftoi anëtarët për takimin që ka zhvilluar me organizatën SIGMA, nga e cila cilat ka marrë premtimin për ndihmë, në veçanti në kontrollin buxhetor. Po ashtu ka marrë premtimin prej tyre rreth përgatitjes së një raporti për financat publike 2007 së bashku me Revizorin Gjeneral.

Besa Gaxherri njoftoi anëtarët për informatën që posedon se anëtarët e Kryesisë së Kuvendit po marrin €250 në muaj mbushje të telefonit. Kjo tregon se është shmangur kompetenca e KBF që të shqyrtoj çdo çështje buxhetore ashtu siç është paraparë edhe me Rregulloren e Kuvendit. Kërkoj nga kryetari i komisionit që të interesohet për dhe të sigurojë informata të sakta rreth kësaj çështje.

Kosara Nikolić pyeti si është e mundur që disa deputet marrin pjesë në dy apo më shumë komisioni e paguhen njëjtë si atë që punojnë vetëm në një komision.

Kryetari lidhur me informatat e znj. Gaxherri për veprimin e Kryesisë rreth beneficioneve të anëtarëve të saj pa u pyetur Komisioni, theksoi se nuk ka informacione dhe premtoi se do të interesohet në Sekretarinë e Kuvendit. Gjithashtu premtoi se do të kërkoj nga të gjitha institucionet të respektohen kompetencat që ka ky Komision lidhur me shqyrtimin e të gjitha çështjeve buxhetore. Lidhur me pyetjen e znj. Nikolic tha se e kupton ankesën e saj por kjo është rregulluar në këtë mënyrë me Rregulloren e Punës së Kuvendit.

Mbledhja përfundoi në ora 13:10

Shërbimi i komisioneve

Kryetari i Komisionit

Gani Koci

